



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:232822
Datë: 23.05.2024
Numri i dokumentit: 05725168

CA.nr.3284/24

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Liridon Maloku, kryetar i kolegjit, Hysni Bardheci dhe Rafet Haxhaj, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit-propozuesit të sigurimit S.R, të cilin e përfaqëson me autorizim avokat I.S, kundër të paditurës-kundërshtares së sigurimit A.H, duke vendosur lidhur me ankesën e propozuesit të sigurimit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.6076/23, të datës 22.01.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 22.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pa themeltë ankesa e propozuesit të sigurimit S.R, dhe VËRTETOHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.6076/23, të datës 22.01.2024.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin e ankimuar C.nr.6076/23, të datës 22.01.2024, ka vendosur më sa vijon: REFUZOHET propozimi i paditësit-propozuesit të sigurimit S.R, për caktimin e masës së sigurisë, me të cilën ka kërkuar që të CAKTOHET masa e sigurisë, dhe të DETYROHET e paditura – kundërshtarja e sigurimit, A.H, që t'i fshij artikujt në lidhje me paditësin – propozuesin e sigurimit, të cilat janë të publikuara me datë 29.10.2023, në portalin “Betimi për Drejtësi”, dhe i ndalohet të paditurës – kundërshtares së sigurimit publikimi i çfarëdo deklarate, prononcimi, informacioni, raporti etj, në lidhje me paditësin – propozuesin e sigurimit, deri në vendosjen meritorë të kërkesëpadisë, si pa bazuar.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor, ankesë ka paraqitur i autorizuari i propozuesit të masës së sigurimit, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën e propozuesit të masës së sigurimit, ta prish aktvendimin e atakuar dhe çështja t'i kthehet të njëjtës gjykatë në rivendosje ose të pranohet ankesa e propozuesit në tërësi si e bazuar dhe të caktohet masa e sigurisë.

I autorizuari i kundërshtarit të sigurimit ka paraqitur përgjigje në ankesë, me propozim që Gjykata e Apelit ta refuzoj ankesën e propozuesit të masës së sigurimit në tërësi si të pa bazuar dhe aktvendimin e atakuar ta vërtetoj.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 e lidhur me nenin 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e propozuesit të sigurimit është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi-propozuesi i sigurimit, përmes të autorizuarit të tij, pranë Gjykatës së shkallës së parë, më datën 01.11.2023, ka ushtruar padi kundër të paditurës-kundërshtares së sigurimit, për shpifje dhe fyerje, me propozim për caktimin e masës së sigurisë, të përshkruar si në dispozitivin e aktvendimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurisë ka mbajtur seancën dëgjimore dhe ndërgjyqësit i kanë paraqitur pretendimet e tyre sa i përket bazueshmërisë së propozimit dhe pas përfundimit të seancës gjyqësore, ka marr aktvendimin e atakuar duke u bazuar në dispozitën e nenit 297 të LPK-së dhe duke e arsyetuar aktvendimin se në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet për caktimin e masës së sigurisë.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkeljet e tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Në këtë drejtim, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, me dispozitën e nenit 297, paragrafi 1 pika a) dhe b) dhe 297 paragrafi 2 të LPK-së, përcaktohet se *“masa e sigurimit mund të caktohet në qoftë se plotësohen në mënyrë kumulative tri kushte dhe atë: besueshmëria ekzistimit të kërkesës apo të së drejtës subjektive, ekzistimi i rrezikut se pa caktimin e masës së sigurimit do të pamundësohet apo vështirësohet dukshëm realizimi i kërkesës dhe deponimi i garancionit”*. Në çdo rast kur nuk plotësohet ndonjëri nga kushtet e sipër theksuara atëherë gjykata nuk mund të vendosë për aprovimin e kërkesës për sigurimin e kërkesëpadisë. Në këtë rast Gjykata e Apelit e pranon në tërësi përfundimin e gjykatës së shkallës së parë se në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet për caktimin e masës së sigurimit, për shkak se paditësi– propozuesi i masës së sigurimit nuk e ka bërë në masë të mjaftueshme të besueshme të drejtën e tij subjektive në raport me rastin në fjalë dhe nuk e ka provuar me prova konkrete materiale ekzistimin e rrezikut se pa caktimin e një mase të tillë paditësit do të shkaktohet dëm i pariparueshëm.

Në rastin konkret Gjykata e Apelit e pranon përfundimin e gjykatës së shkallës së parë për mos caktimin e masës së sigurimit, për shkak se kjo e fundit e ka arsyetuar në masë të mjaftueshme përfundimin e saj për refuzimin e caktimit të masës së sigurimit. Kjo për faktin se ka rezultuar se propozuesi i sigurimit nuk e ka bërë të besueshme në masë të mjaftueshme ekzistimin e kërkesës respektivisht të drejtës së tij subjektive, e po ashtu nuk e ka argumentuar faktin se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së tillë do të pamundësohet apo vështirësohet realizimi i kërkesës, për shkak të publikimit të informacionit nga ana e kundërshtarit të sigurimit. Gjykata e Apelit vlerëson se në kontekstin e rrethanave të paraqitura në këtë çështje juridike kontestuese e që i referohen pretendimeve të paditësit – propozuesit të sigurimit lidhur me përhapjen e mëtejshëm të informacionit të rremë, dhe në këtë fazë të procedurës konsiderohet i drejtë qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë se caktimi i masës së sigurisë në këtë fazë të procedurës nuk është i

arsyeshëm dhe i bazuar, ngase kërkesa që të ndalohen publikimet e ardhshme është në kundërshtim me kushtet e përcaktuara nga neni 16 par.2 i LCKSHF “Urdhëresat gjyqësore paraprase për të ndaluar përhapjen apo përhapjen e mëtejshme të informacionit, mund të lëshohen vetëm kur publikimi tanimë është kryer dhe kur personi që pretendohet të jetë i dëmtuar mund të sigurojë se informacioni i ka shkaktuar dëm reputacionit të tij apo të saj, dhe se individit që pretendohet të jetë i dëmtuar do të pësojë dëmtim të pazëvendësueshëm si rezultat i përhapjes së mëtejshme”. Po ashtu kufizimi eventual i një mediumi që të mos publikoj kurrfarë lajmi, deklaratë apo publikimi për një person të caktuar është në kundërshtim edhe me nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe nenin 40 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Mirëpo, kjo nuk do të thotë që me ndryshimin e rrethanave në secilën fazë të procedurës, pala paditëse të mos ketë të drejtë të bëjë sërish propozim për caktimin e masës së sigurisë, me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të saj subjektive, pasi që një mundësi të tillë e lejojnë dispozitat ligjore të LPK-së.

Gjykata e Apelit i ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera ankimore të paraqitura në ankesë, por ka gjetur se janë të pathemelta dhe se nuk ndikojnë që gjykata të merr një vendim ndryshe. Por, në rastin konkret gjykata ankimore ka vlerësuar se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paraqitura me ankesë për shkak se gjykata e shkallë së parë përfundimin e saj e ka arsyetuar në masë të mjaftueshme sa i përket rrethanave që kanë ndikuar për refuzimin e kërkesës për caktimin e masës së sigurisë. Në anën tjetër, për gjykatën e shkallës së dytë është i pranueshëm konstatimi i gjykatës së shkallës së parë i dhënë në arsyetim të aktvendimit të atakuar, që ka të bëjë me faktin se vendosja rreth propozimit për caktimin e masës së sigurisë, nuk ka të bëjë me vendosjen në mënyrë meritore rreth kërkesëpadisë së paditësit. Ndërsa për këtë të fundit sigurisht se gjykata e shkallës së parë do të vendos pas mbajtjes së seancave gjyqësore, si dhe pas administrimit dhe vlerësimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse.

Prandaj, bazuar në të lartcekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 208 dhe 209 pika b) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
CA.nr.3284/24, me datë 22.05.2024

Kryetar i kolegjit-Gjyqtari
Liridon Maloku